



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
AGJENCIA SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Nr. 258/1 Prot.

Tiranë, më 21.11.2018

K O N T R A T Ë

E lidhur sot në datë 21/11/2018, në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës midis palëve :

AUTORITETI **KONTRAKTOR:** Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, (Agjencia) përfaqësuar nga Kryetarja Znj. Alma Tandili, e quajtur më poshtë Bleresi.

KONTRAKTUESI: Operatori Ekonomik "Studio Tartari" shpk meni p L81317045A ,
përfaqësuar nga Administratori Z. Arvid Tartari, i quajtur më poshtë kontraktuesi.

Bazaligjore: Kontrata hartohet në bazë të dispozitave ligjore të parashikuara në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", indryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

NENI 1
Objekti i Kontratës

1. Objekti i kësaj kontratë është : **"Prodhim materialesh në kuadër të javës së të drejtave të fëmijëve "**.

NENI 2
Sasi dhe Vlera e kontratës

1. Kontraktuesi do të prodhojë materialet më poshtë vijon:
 - a) Bluza të stampuara
 - 50 copë bluza për fëmijë (10 masa S dhe 40 masa M)
 - 50 copë bluza për të rritur (25 masa X dhe 25 masa XL)

Bluzat duhet të jenë pambuku, me ngjyrë të bardhë. Në pjesën përpara do të ketë shkrimin #Fëmijët për të, në pjesën e pasme do të ketë të stampuar logon e Agjencisë.

b) Byzylykë plastikë, me ngjyra të ndryshme, me gjërësi 1.2 cm,

- 100 copë me diametër të përshtatshëm për të rritur
- 100 copë me diametër të përshtatshëm për fëmijët.

Tek byzylykët do të stampohet logo e Agjencisë, emri i institucionit (Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe eëëfëmijët.gov.al

c) Kapele me rrethor të rregullueshëm

- 50 kapele ngjyrë të zezë
- 50 kapele ngjyrë të kuqe

Në kapele do të stampohet logo e Agjencisë

d) 100 copë adevive për tu ngjitur në rroba me logon e agjencisë, formë katrore 6 cm me 6 cm.

2. Vlera e Kontratës është :92 800*lekë* pa TVSH

NENI 3

Afati

1. Kontraktuesimerrpërrealizimin e objektit të kontratës brenda 3 ditëve nga data e lidhjes së kontratës.

NENI 4

Zgjatja e afatit

1. Zgjatja e afatit të kontratës bëhet me dakortësinë e palëve dhe bazuar në urdhërin e nxjerrë nga Autoriteti i Kontraktorit për ndryshimin e afatit për realizimin e objektit të kontratës.

NENI 5

Afatet e pagesës

1. Pagesa do të kryhet në lekëshqiptarë në llogarinë e kontraktuesit me Urdhër Xhirimi.

2. Pagesa do të kryhet brenda ditëve nga momenti i marrjes në dorë të objektit të kontratës nga Autoriteti i Kontraktorit.

20

NENI 6

Detyrimet e kontraktuesit

Operatori Ekonomik "Studio Tartari" shpk, me cilesinë e kontraktuesit është detyruar:

1. Të realizojë objektin e kontratës brenda datat e të përcaktuara në nenin 3, paragrafi 1, të kontratës.
2. Të realizojë objektin e kontratës në përputhje me specifikimet e vendosura në ftesën për ofertë.
3. Të dorëzojë pranë zyrave të Autoritetit të Kontraktormaterialet, objektet e kontratës.

NENI 7

Detyrimet e Blerësit

Autoriteti Kontraktor Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, është detyruar:

1. Të kontrollojë realizimin e objektit të kontratës;
2. Kur Autoriteti Kontraktor konstaton se objekti i kontratës nuk është realizuar sipas kritereve të përcaktuara në ftesën për ofertë rezervontë drejtë për të mos marrë dorëzim objektin deri në momentin e realizimit dhe plotësim të tij sipas ftesës për ofertë.

NENI 8

Zgjidhja e kontratës

1. Kontrata zgjidhet në rastet kur:
 - a) kapërfunduar afati i përmendur në Nenin 3 pika, 1 të kësaj kontrate.
 - b) Kur realizimi i objektit nuk i përgjigjet standartit dhe cilësisë së kërkuar nga Blerësi

NENI 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet mes palëve lidhur me zbatimin e kushteve të kësaj kontrate kur nuk janë zgjidhur me pajtim, kompetente për zgjidhjen e konfliktit është Gjykata Administrative e Rrethit Tiranë.

Kjo kontratë u hartuanë 4 (katër) kopje duke u firmosur nga palët në dy kopje. Një kopje e kontratës ju dorëzohet kontraktuesit dhe 3 (tre) kopje qendrojnë në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

**AUTORITETI KONTRAKTOR
AGJENCIA SHPETËRORE TË DREJTAT
DHE MBROJTJEN E FËMIJËS**

Zaj. Alma Tani

KRYETARI

KONTRAKTUESI

Z. Arvid Tartari

Arvid Tartari

ADMINISTRATOR

